



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:273861

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05749960

KPPP.nr.497/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Scandinavian Cleaning System” SH.P.K., me NUI:810008096, me seli në Mitrovicë, rruga “Mbretëresha Teutë”, kundër debitorit “Hotel Palace & Spa Center” SH.P.K., me NUI:811327635, me seli në Mitrovicë, fshati Shupkocv, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.271/2021 të datës 08.11.2021, të Përmbartuesit Privat Ilmi Miftaraj, me seli në Mitrovicë, jashtë seancës me datën 29.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Hotel Palace & Spa Center” SH.P.K., dhe urdhri përmbartimor P.nr.271/2021 i datës 08.11.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Ilmi Miftaraj SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Scandinavian Cleaning System” SH.P.K., ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.271/2021 të datës 08.11.2021, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr.017/21 të datës 31.08.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që në afat prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin, në emër të borxhit, kreditorit t’ia paguaj shumën prej 922.76 €, me kamatëvonesë prej 8% në vit, duke filluar nga data kur kredia është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës së përmbartimit. Në rast se nga ekzekutimi i llogarive bankare nuk do të arrihet përmbushja e obligimeve atëherë ekzekutimi të vazhdoj me regjistrimin e

patundshmërive dhe sendeve të luajtshme të debitorit dhe më pas shitjen e tyre përmes ankandit publik e nga shuma shitjes të realizohet borxhi.

Debitori në prapësimin e paraqitur e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se fatura që pretendon kreditori se i takon debitorit, nuk është e regjistruar e as e pranuar nga ana e debitorit, e njëjta nuk përmban nënshkrimin e as vulën e debitorit. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbartimor ta anuloj.

Kreditori në përgjigje në prapësim e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit duke theksuar se ka tentuar që t'ia dorëzoj faturën kreditorit por i njëjti nuk ka qenë në objekt, ndërsa pas një dite i ka ftuar në zyre duke i njoftuar se fatura si e tillë nuk mund të pranohet pasi që në faturë janë përfshirë edhe disa pajisje të cilat i kanë humbur kreditorit. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, andaj të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se Fatura Nr.017/21 e datës 31.08.2021, në bazë të së cilës është mbështetur propozimi për përmbartim është bashkëngjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit, e rrjedhimisht propozimi për përmbartim është paraqitur në kundërshtim me nenin 38 par.1 të LPP-së i cili përcakton se *“Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm..”*

Sipas nenit 43, par.4 të LPP-së përcaktohet se: *“...Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarueshmërisë së nxjerrë nga përmbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarim nga përmbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”* .

Bazuar në dispozitën e sipërcituar, gjykata gjeti se në rastin konkret urdhri përmbarimor P.nr.271/2021 i datës 08.11.2021, është nxjerrë pa plotësimin e kushteve për lejimin e përmbarimit, ngase propozimi për përmbarim bazohet në një dokument kopje dhe si i tillë përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen nga gjykata, ngase në fazën e mjetit juridik, gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrin.

Meqenëse në rastin konkret, sipas vlerësimit të gjykatës nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarim, ndërsa organi përmbarues - përmbaruesi privat, nuk ka vepruar konform nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Në rast se propozimi për përmbarim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”*, gjykata shfuqizoi urdhrin përmbarimor dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 43, nenit 71 dhe nenit 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.497/24, datë 29.05.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.